



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



---

## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së pestë të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, mbajtur më 04.10.2021, e cila filloi në orën 13:30.**

**Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e komitetit: Ramadan Salihu, Jeton Canhasi, Mehreme Llumnica, Armend Ademi, Ermira Shabani dhe Gyltene Retkoceri.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm Premtime Preniqi, koordinatore e njësisë për të drejtat e njeriut dhe Besa Preniqi interprete.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, duke ua dhenë fjalën anëtarëve të komitetit që ti propozojnë pikat e rendit të ditës.**

**Armend Ademi paraqiti çështjen e parkingjeve, tha se kërkesat më të mëdha po i kanë nga anëtarët e shoqatës ku të parkingu nëntokësor të "Pallatit të Rinisë" sa kemi informata është në pronësi të Komunës dhe kohëve të fundit kanë filluar të mos lejojnë me hyrë ku deri tani kanë hyrë anëtarët e shoqatës të liruar me librezë të shoqatës, por tani ju kanë thënë se e ka marrë një kompani private parkingun në menaxhim.**

**Po ashtu pyeti se parkingu nëntokësor a është i lidhur me atë parkingun që është mbrapa "Pallatit të Rinisë" që është i Komunës apo është i vetëm.**

**Premtime Preniqi tha të gjitha parkingjet kanë kaluar në "Prishtina Parking".**

**Armend Ademi pyeti se a mundemi me marrë ndonjë vërtetim apo Vendim për me shfrytëzuar parkingun.**

**Premtime Preniqi u përgjigj dhe e cila tha se duhet me ju drejtuar drejtorisë për të marrë informata se si është e rregulluar kjo çështje.**

**Armend Ademi pyeti se përgjegjësi e kujt është që ne mundemi me ju drejtuar.**

**Premtime Preniqi** u përgjigj drejtpërdrejt duhet me u drejtuar te "Prishtina Parking" dhe njëkohësisht të njoftohet edhe drejtori i Mirëqenies Sociale dhe Medina Braha, drejtoreshë.

**Mehreme Lumnica** tha se ka dy pika me u diskutuar: E para muaji tetor është muaji i mundësive të punësimit dhe duhet diskutuar këtë çështje që po i marrin nga 2-3 ditë në javë sa është efektive dhe e dyta janë zgjedhjet dhe se kemi informacione se kandidatë me aftësi të kufizuara, ku 11 janë për asamblistë në nivel të Kosovës një e kemi në Komunë të Prishtinës dhe është mirë me lobuar për te.

**Premtime Preniqi** tha se mundeni me biseduar në lidhje me këtë çështje që të paktën ku mundeni ju me lobuar si Komitet i PAK, dhe ti nëse i jep votën dikujt jepja ati me aftësi të kufizuara.

**Mehreme Lumnica** tha se kishte qenë mirë me diskutuar rreth situatës së pandemisë ndonjë informacion, ndonjë shërbim që na ka ikur për situatën aktuale etj. dhe me lobuar rreth vaksinimit të personat dhe familjarët e PAK-ut, për rëndësinë e vaksinimit.

**Gyltene Retkoceri** tha se me sa po shohë unë në përgjithësi janë duke u vaksinuar, është një çështje që e kanë bërë në mënyrë indirekte të informuar, nuk mund të hyni në punë në sektorin publikë, nuk mundesh me hy në lokale etj.

**Premtime Preniqi** tha nuk kam njohuri në Prishtinë a po shkojnë në shtëpi mi vaksinuar të sëmurit, të moshuarit se në komunat tjera po.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se edhe në Prishtinë kanë shkuar nëpër shtëpi me bërë vaksinimin e të moshuarve dhe atyre me sëmundje kronike.

**Kryesuesja konstatoi se u miratua ky**

#### **REND DITE:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;
2. Informatë rreth Miratimit të Planit të Veprimit dhe monitorimit;
3. Zgjedhjet dhe mundësitë e PAK-ut, për votim dh përfaqësim;
4. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.**

**Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.**

## **Pika e dytë**

### **Informatë rreth Miratimit të Planit të Veprimit dhe monitorimit.**

**Premtime Preniqi** tha se sa i përket Planit të Veprimit, prezenca e Mehremes i ka dhënë një kaheje shumë pozitive dhe i ka bërë me u ndie keq për mos punën e tyre, kështu që unë mendoj sa të fillojmë me qeverisjen e ardhshme do t'iu dërgoj në emër të Komitetit ose së bashku e dërgojmë Planin e Veprimit për secilën drejtori me pjesët e tyre që ta kenë parasysh në planin e tyre.

**Mehrenme Llumnica** tha se si para përgatitje për monitorim njëherë informimi mandej shpërndarja e tij. Po ashtu ceku se falënderimi më i madhi i takon Muhedin Nushit i cili ka qenë përkrahës që nga themelimi i Komitetit ku shumë gjëra kanë shtyrë përpara me Premtimen.

Edhe në Kuvendin Komunal Muhedin Nushi ma ka dhënë mundësinë për fjalimin së bashku me kryesuesin e Kuvendit.

**Ramadan Salihu** tha se është bërë një punë e madhe që është miratuar Plani i Veprimit. Miratimi i Planit të Veprimit ne si Komitet edhe ashtu e kemi të përshkruar në punën tonë dhe kemi eksperiencë të monitorimit dhe ne duhet menjëherë të fillojmë me bërë monitorimin sipas detyrës në mënyrë legale d.m.th. Asambleja ka marrë Vendim edhe pse bëhet ndërrimi i strukturave ose ndërrimi i asamblistëve kjo nuk do të thotë se Vendimet e tyre janë të pavlefshme kështu që ne konsiderojmë pa marrë parasysh se kush vjen në udhëheqje këtë Plan të Veprimit obligatorë për secilin dikaster dhe secilin institucion.

Gjatë monitorimit të më përparshëm kemi arritur në bazë të analizave me pa se dikund është monitoruar në masën 60% në mënyrë kualitative ndoshta edhe ma shumë. Esenca e Planit të Veprimit sillet rreth punësimit të PAK-ut dhe ky do të jetë fokusi i gjithë neve dhe gjithë atyre që llojnë për PAK-un.

**Premtime Preniqi** tha se me hapjen e një vendi të punës që i ofrohet PAK-ut është një plus se po i zgjidhet çështja dhe faktikisht po largohet një person prej ndihmës sociale dhe po i ofrohet me punuar si person i socializuar i pjesës së shoqërisë.

**Ermira Shabani** tha se çështja tjetër që lidhet me Planin, kjo pjesa e të dhënave nga Komuna e Prishtinës a ka ndonjë data bazë për PAK.

**Premtime Preniqi** tha se tani me GIZ-in, kemi filluar me bërë një data bazë, në lidhje me PAK-un në Komunën e Prishtinës.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se realisht një data bazë të tillë e ka Drejtoria e Arsimit.

**Ermira Shabani** tha se po e ka edhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale, mirëpo është dashur me pasur edhe Drejtoria e Shëndetësisë, duhet me qenë një nivel komunal që janë krejt.

**Premtime Preniqi** tha se ndoshta ishte dashur me qenë në nivel Qendror dhe me qenë i gjithë PAK-u sepse Drejtoria e Arsimit i ka vetëm ata që janë në arsim, drejtoria e Mirëqenies Sociale i ka vetëm ata që marrin shërbime sociale.

Ne me GIZ-in jemi duke u munduar me bërë një data bazë me qenë një data bazë komplet dhe mu ditë që secili me pasur atë qasjen secila drejtori, e sa realizohet e ka Komuna me GIZ-in.

**Gyltene Retkoceri** tha se nuk jam në dijeni apo nuk kamë informata ende nuk ka pas një shpallje për pranimin e asistentëve për persona me nevoja të veçanta.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se mësues mbështetës kanë pranuar në vend të asistentëve i kanë marrë 10 mësues mbështetës dhe kanë filluar punën.

**Ermira Shabani** pyeti a ka qenë pozita për asistent apo mësues mbështetës.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se pozita ka qenë për mësues mbështetës i kanë punësuar 10 persona dhe i kanë nda nga dy grupe nëpër shkolla i kanë mbuluar 20 shkolla në Komunën e Prishtinës, ndërsa për asistentë ndahet buxheti në vitin 2022.

**Mehreme Llumnica** tha se në realitet për asistente e kanë ndarë buxhetin Ministria e Arsimit mirëpo ne tani duhet me u interesuar se Drejtorja e Arsimit a e ka atë buxhet apo e destinon për diçka tjetër. Ne si Komitet duhet me monitorua me shikuar se ku po shkojnë ato mjete.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se më duket e ka destinuar për mësues mbështetës.

**Ermira Shabani** tha se problem ka qenë kodi i linjës se gabuar dhe burimet njerëzore atë linje e kanë përdorur për pozita të tjera jo për pozitën e asistentit. Po thuaj të gjitha komunat e tjera e kanë hapur konkursin për asistentë, Komuna dhe MASH-ti duhet me sqaruar kodin e linjës e mos të jetë arsyeja e njëjtë.

Mendoj kishte me qenë mirë si komitet me ju drejtuar me një email, Drejtorisë së Arsimit dhe me kërkuar një sqarim se çka ka ndodhur, si është situata dhe për këtë pjesën e mësuesve mbështetës unë nuk kam ndonjë informacion se është hap konkurse.

**Mehreme Llumnica** tha se nuk e di sa është në kompetencë tonën por si komitet mbasi kemi informacione të sigurta me shkuar një takim në drejtori, në Ministri të Arbërie Nagavcit se ajo është zotuar se kanë qenë mjetet.

**Premtime Preniqi** sugjeroi që me marrë mendimin prej Drejtorisë së Arsimit nëse ajo ja hedh fajin burimeve njerëzore, unë i kamë dy Vendime që mi kanë dërguar prindërit, një është Vendim i Ministrisë së Arsimit, ku Ministria thotë se prej këtij viti ja kemi dërguar buxhetin Komunës dhe një grup i prindërve të PAK -ut që kanë bërë ankesë në Komunë. Drejtorja e Arsimit ju ka thënë se problemi është të burimet njerëzore, unë këto dy dokumenti i kamë dërguar të burimet njerëzore por përgjigje ende s'kam marrë.

**Ermira Shabani** tha se mundemi me i dërguar një email ku vendosin zyrtarët e arsimit, Ministrisë, zëvendës ministrit, Drejtorisë së Arsimit, burimeve njerëzore dhe kuptohet me i koordinua krejt thënie.

**Premtime Preniqi** sugjeroi që për këtë çështje të informohet edhe Shpend Ahmetin, Muhedin Nushin, që me ditë pse nuk janë pranuar këta asistentë.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese,** e mori përgjegjësinë me shkruar një email për çështjen e asistentëve e pastaj me ju dërguar anëtarëve nëse kanë diçka me shtuar ose me hequr e pastaj e dërgoj në Ministri, zëvendës ministrit, Shpend Ahmetit, Muhedin Nushit, Burimeve njerëzore, Shpresa Shalës dhe Albulena Ahmetit zyrtares për PAK-un.

**Ermira Shabani** tha se nëse e mbani një aktivitet, një takim mundeni me i dërguar fotot dhe një përshkrim të aktivitetit dhe me postuar.

**Ramadan Salihu** tha se kemi qenë disa vende dhe nuk është dhënë informacion për publikun, megjithatë njerëzit dëshirojnë me ditë se çka po punohet.

**Armend Ademi** propozoi që Premtimja pasi që është çdo herë në rrjedha të këtyre ngjarjeve me qenë një person që i poston të gjitha sendet le të jetë një dorë se ne ndoshta mbas një kohe nuk jemi anëtarë të komitetit e Premtimja është tanë kohën.

**Premtime Preniqi** tha se është më tepër në aspektin teknik me bërë organizimin dhe me i mbajt takimet.

**Ramadan Salihu** tha se Prishtina online do të ishte obligatorë me i bërë postimete.

**Fatime Demolli - Mustafa kryesuese**, tha se zyrtarja për Teknologji Informative Gresa Deda i publikon ekstraktet, rendet e ditës i ka të caktuara e këto tjerat nuk mundet.

**Mehreme Llumnica** tha se atë ditë kur u miratua Plani i Veprimit është diskutuar që ka me qenë një seancë enkas kur të bëhet zgjidhja e drejtorëve me raportua drejtorët për dikasteret e tyre sa kanë PAK.

Edhe ato revidimet e Planit që i kemi bërë te Plani i Veprimit, plotësimet për transportin publik, janë do pika që i ka qitë Hendikosi që i kem raportuar këtu është me rëndësi mu bërë disa plotësime.

**Premtime Preniqi** tha se kur të zgjidhen drejtorët ne e mbajmë mbledhjen e radhës i ndajmë këto pika se cilës drejtori duhet me ju drejtuar.

#### **Pika e tretë**

#### **Zgjedhjet dhe mundësia e PAK-ut për votim dhe përfaqësim.**

**Mehreme Llumnica** informoi se është një qytetar me aftësi të kufizuara, është anëtar i Hendikosit dhe partia e ka zgjedhur si kandidat për asamble Komunale dhe ka qenë 3 vite monitorues i Asamblesë Komunale të takimeve të rregullta prej Hendikosit dhe është lobus i PAK-ut ka raportuar për ta. Ka pasur propozime në parti se ky mundet me qenë kandidat me përfaqësuar mirë se e njehë fushën e aftësive të kufizuara, është mirë me lobuar për të se është zëri i qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe i njeh ndryshe sendet.

**Ramadan Salihu** tha se ne jemi mbështetës dhe krejt politika e komitetit është që të llobojmë, t'iu shkruajmë ose të bashkëpunojmë me partitë që në mesin e tyre në listat zgjedhore të fusin sa më shumë PAK-un se kemi kandidat PAK-ut ndërsa cilit person me ja dhëne votën ajo është çështje individuale dhe komiteti nuk është që do të merret me të, me të do të merren shoqatat.

#### **Të ndryshme**

**Armend Ademi** tha sa i përket parkingjeve ne me kontaktuar me këta mbasi qenka me zona parkingu nëpër Prishtinë me marrë një dokumente prej tyre a ju lejohet ndoshta në ndonjë zonë apo tri zonat veç ju lejohet me detajisht.

**Ramadan Salihu** tha se kemi thënë edhe më herët ne mundemi me lobuar vetëm për ato që janë të parapara me ligj d.m.th. me ligj është lirimi nga pagesa vetëm për transport, parkingjet nuk janë mirëpo me Planin e Veprimit që është miratuar qe dy herë edhe ai është paraparë lirimi nga pagesa e parkingut. Andaj duhet me shkuar së pari me kërkuar prej drejtorisë

përkatëse të Komunës edhe prej secilës kompani cila do s'ka lidhje që është private se ajo kur ka konkurruar për licencë i ka pranuar ligje e Komunës.

**Premtime Preniqi** tha "Prishtina Parking" nuk është parking privat ajo është ndërmarrje publike.

**Mehreme Llumnica** dha sqarime se kanë kontaktuar me drejtorin e parkingut "Prishtina Parking" e kanë bërë këtë kërkesë, mirëpo ata ju kanë përgjigjur se i kanë me ligj vetëm caktimin e pikave, parkingjet për përdoruesit e karrocave e për lirim nga pagesa nuk kemi se duhet me dal një Vendim prej Komunës, një rregullore kështu që kjo punë ishte larg mu realizuar.

**Ramadan Salihu** tha se ka të drejt se atë rregullore, Vendim që ka thënë ai, drejtoria e dinë ku me gjetë dhe kur mi lëshuar por duhet mi shkruar me shkrim dhe fizikisht me shkuar me biseduar me ta se vet asambleja e ka miratuar.

**Jeton Canhasi** tha se ka propozuar më herët secilit PAK, Komuna apo Komiteti me i pajisur me një tiketë që e ngjet në automjet dhe deshifrohet se ai automjet është parking për PAK.

**Ramadan Salihu** tha se tiketa vetëm apo çfarë do shenje është me e rezervuar parkingun a ndërsa lirimi nga pagesa është diçka tjetër.

**Armend Ademi** tha se kishte mjaftuar librezat e anëtarësimit e shoqatave që i kemi.

**Premtime Preniqi** tha se gjithë kund në botë është kjo, vendoset tiketa dhe nuk hiqet duhet me pas gjithë qysh një shenjzim.

**Mehreme Llumnica** tha se "Hendikosi" i ka shpërndarë këto tiketa nëpër vetura.

**Premtime Preniqi** tha se kur të bëhet Vendimi për mi dhënë këto shenjzimet faktikisht njëjtën kohë mu bërë Vendimin për lirim të pagesës ose me pagesë më të vogël, të arsyeshme e kisha parë edhe me zbritje me qenë, nëse është 1 euro për PAK me qenë 0.50 centë, ne duhet me kërkuar cilën ta zbatojnë.

**Armend Ademi** tha se të jetë sikurse te arsimit si me transport publikë po lirohen e njëjta me qenë edhe për parkingje.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese**, e sugjeroi Armendin që të përgatit e ti cekë këto çështje dhe t'ju dërgon email Habib Qorrit, Medina Brahës, "Prishtina Parking", Liridon Restelicës dhe të gjitha kompanive edhe atyre private, Shpend Ahmetit dhe Muhedin Nushit.

**Jeton Canhasi** sugjeroi që nuk duhet mu barazuar PAK ata që janë të palëvizshëm e që janë në karrocë me ata që janë në gjendje me ec.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se në një takim me DKA-në dhe mësuesit e rinj mbështetës kam një kërkesë që ne si Komitet me organizuar një trajnim me bashkëpunuar me Shoqatën e të shurdhërve dhe DKA - në për mi trajtuar mësuesit mbështetës për gjuhën e shenjave.

**Armend Ademi** tha se për momentin është problem me gjetur ndonjë instruktorë të gjuhëve të shenjave se në Prishtinë jemi vetëm tre që jemi me certifikata që i kemi kryer tri vite dhe jemi të certifikuar, një asistente të gjuhës së shenjave e kemi në shkollën "Elena Gjika", unë jam i zënë dhe Rina që punon në Qendrën burimore Prizren.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se çka mundeni Armend si shoqatë me bërë me dhënë një kontribut për mësuesit e rinj mbështetës së paku nja dy ditë trajnim për njohuri elementare, po ashtu pyeti sa i duhet një mësuesi mbështetës me mësuar për bazë.

**Armend Ademi** tha se në fillim nga 1 orë e gjysmë nga pak, se është problem me i zotuar të gjitha për njëherë, vetëm këto çka i duhen për komunikim, ndërsa sa i duhet mësuesit mbështetës për mësim bazë është 6 muaj -1 vit.

Po ashtu tha se nuk mundet me dhënë ndonjë datë të saktë se është i angazhuar shumë në Shoqatën Kosovare, se është i angazhuar me një projekt por do të mundohet të kontaktoj me Rinën dhe Vjollcën cila është ma e lirë.

**Pretime Preniqi** u interesua se instruktorët e gjuhës së shenjave çfarë pune kryejnë kur të gjejnë vetë me mësuar di kënde apo çfarë detyra të punës ka.

**Armend Ademi** tha se instruktori i gjuhës së shenjave për momentin është i fokusuar me ja mësuar gjuhën e shenjave prindërve që kanë fëmijë të shurdhët, familjarëve të shurdhëve.

**Pretime Preniqi** u interesua se organizimi i kësaj për mi mësuar prindërit a bëhet prej shoqatës pa pagesë apo kush i mbulon, si paguhen.

**Armend Ademi** dha sqarime se Shoqata Kosovare Qendrore, ata e kanë mbajte edhe projektin nuk është që nuk është mbajte në nivel lokal. Kemi bashkëpunim me ta nuk ka problem vetëm bashkëpunimi me Ministrinë për me ju mbështet këtë trajnimin 3 vjeçar ata e kanë nivel qendrorë. Tani janë ne Ministrinë e Arsimit në bisedime për mi punësuar ma shumë asistentë së paku këta 15 me i sistemuar ku ka nevojë ma së shumti, se vetëm 5 janë të punësuar.

**Ramadan Salihu** u interesua se Qendra burimore në Prizren si i mëson nxënësit ajo a ka instruktorë apo arsimtarë të licencuar apo si i mëson.

**Armend Ademi** dha sqarime duke cekur se për këtë e kanë bërë me pasur asistentë dhe instruktorë, që mësuesi i jep instruktorit ose asistentit e ai e transmeton te fëmija. Kanë bashkëpunim mësuesi ma së pari me personin e shurdhët që ja mëson gjuhën e shenjave e përcjell përmes tij për këtë edhe niveli i arsimit është i ulët se nuk është që ka pas ndonjë farë mësimdhënësi.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:10.*

**Procesmbajtësja:**  
**Shyhrete Islami**

